



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

RELACION

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 181 DATË 28.12.2022 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023”

Bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në VKM nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar, është miratuar niveli i pagave me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 181 datë 28.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në institucionin e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2023”. Sipas VKM nr. 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” është përcaktuar se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi është 40,000 (dyzet mijë) lekë. Për këtë arsye kërkohet për Bashkinë Korçë dhe Ndërmarrjet në varësi të miratohet paga minimale për kategoritë sipas VKM-së nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar.

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike
dhe Menaxhimit Burimeve Njerëzore
Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**

**Drejtoria e Përgjithshme e Financës,
Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
Valbona Ziko**

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq Filo**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 181 DATË 28.12.2022 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023”

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në VKM nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar dhe në VKM nr. 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

VENDOSI:

1. Të miratohet paga minimale në vlerën 40,000 lekë për kategoritë sipas VKM-së nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar.
2. Efektet financiare të rritjes së pagës minimale do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Ndërmarrjet e varësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Erjon NEXHIPI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____